

Perjashtohen nga taksa mbi ndertesën :

___**A**___Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore, qe perdoren per qellime jofitimpruese .

___**B**___Ndertesat e banimit qe shfrytezohen me qera dhe qe jane te paliberalizuara.

___**C**___Ndertesat qe perdoren nga komunitetet fetare.

___**D**___Pasurite ne pronesi te shtetit, te kaluara me VKM, nen administrimin e shoqerive publike shteterore.

___**E**___Banesat sociale ne pronesi te Bashkise.

___**F**___Pasurite e subjekteve te ndryshme te marra me qera nga Bashkite.

___**G**___Perjashtohen gjithashtu, pensionistet (vetem).

Per kategorine e fundit perjashtimet behen vetem ne rastin kur perfituesi eshte kryefamiljar, cka vertetohet me certifikaten familjare te leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Bashkise Finiq dhe vertetimit nga Sigurimet Shoqerore qe figurojne si pensionist.

Per ndertesat ne pronesi te shoqerive te ndertimit te destinuar per shitje, por qe jane ende te pashitura , taksa do te vendoset sipas destinacionit .

___Per banesat ku mungon dokumenti i pronesise te meret nje siperfaqe masatare prej 100 m2.

___Taksa e ndertesës ne fshat mund te vilet me agjent tatimor ose ne filialet e “Postes “ sha.

Ne zbatim te nenit 20 te ligjit 181/2013 date 28.12.2013, Z.R.P.P . duhet ti ofroje Bashkise te dhenat e rregjistrit elektronik te pasurise.

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim I nivelit te takses me bazen e taksueshme. Siperfaqia në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi dhe në rastin e mungesës së dokumentacionit, perdoruesi i ndertesës ben nje vetdeklarim te siperfaqes se ndertesës, prane bashkise ku ndodhet ndertesa.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si dokumentacion një nga dokumentat e mëposhtme:

- Vërtetimin e pronësisë
- Vendimet e komisionit të kthimit të pronave
- Vendimet e privatizimit
- Vetdeklarimin
- Vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtshme

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës mbi ndërtesat, për subjektet private dhe famuljet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Finiq.

